

RAPORT VJETOR

KËSHILLI I STATISTIKAVE VITI 2023

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2023, Këshilli i Statistikave vijoi mandatin e tij ligjor për të mbikëqyrur dhe këshilluar zhvillimin e Statistikave Zyrtare në Shqipëri, në përputhje me Ligjin nr. 17/2018 “Për Statistikën Zyrtare” dhe me parimet e Kodit Evropian të Statistikave.

Në një vit të karakterizuar me aktivitete të rëndësishme institucionale dhe procese statistikore, përfshirë aktivitetin mbi Censin e Popullsisë dhe Banesave 2023 dhe avancimin e punës për Censin e Bujqësisë, Këshilli ka vlerësuar progres të qëndrueshëm, rritje të transparencës dhe një orientim të qartë drejt forcimit të kulturës së vendimmarrjes së bazuar në evidencë.

Raporti përmbledh vlerësimet, gjetjet dhe rekomandimet kryesore që synojnë mbështetjen e konsolidimit të Sistemit Statistikor Kombëtar.

MANDATI LIGJOR DHE ROLI

Këshilli i Statistikave ushtron funksionet e tij në mbështetje të një sistemi statistikor të besueshëm, të pavarur dhe të orientuar nga nevojat e publikut, në përputhje me kompetencat e përcaktuara në Ligjin e Statistikave Zyrtare, përfshirë:

- Dhënien e mendimeve për Programin Pesëvjeçar të Statistikave Zyrtare
- Planet vjetore hartuar në bazë të PSZ pesë vjeçare
- Monitorimin e zbatimit të planit vjetor të statistikave;
- Vlerësimin e performancës së statistikave zyrtare dhe progresit drejt standardeve europiane;
- Promovimin e transparencës, qasjes dhe përdorimit të statistikave.

VEPRIMTARIA GJATË 2023

Në vitin 2023, Këshilli i Statistikave zhvilloi dy mbledhje zyrtare .

Mbledhja e parë u mbajt më datë 3 korrik 2023, e cila kishte në fokus konstituimin e përbërjes së re të Këshillit, zgjedhjen e Kryetares dhe Nënkryetarit të Këshillit. Këshilli i riformatuar mori në shqyrtim raportin e monitorimit të Programit të Statistikave Zyrtare për periudhën Janar–Prill 2023. Ky takim shënoi rikthimin e plotë të veprimtarisë së Këshillit pas ndryshimeve në përbërje dhe rivendosi ritmin e rregullt të funksionimit institucional.

Gjatë vitit 2023, Këshilli i Statistikave është informuar mbi ecurinë e përgatitjeve dhe zhvillimeve të Censit të Popullsisë dhe Banesave 2023. Bazuar në raportimet e paraqitura, Këshilli u njoh me finalizimin e pyetësorit të Censit dhe materialeve metodologjike shoqëruese, me realizimin e testeve teknike të aplikacionit dhe funksionaliteteve të tij, si dhe me trajnimin e strukturave të INSTAT në 61 bashki. Po ashtu, Këshilli mori informacion mbi finalizimin e platformave të mbledhjes së të dhënave për Njësitë Ekonomike Familjare, progresin në rekrutimin dhe trajnimin e stafit të terrenit, aktivitetet e komunikimit dhe ndërgjegjësimit publik, si dhe si dhe me ecurinë e përgatitjeve logjistike të domosdoshme për realizimin e procesit.

Mbledhja e dytë u zhvillua më 23 tetor 2023 dhe u përqendrua në diskutimin e Draft-Planit Vjetor të Statistikave për vitin 2024, si edhe në prezantimin dhe vlerësimin e progres-raportimit për periudhën maj–gusht 2023. Në kuadër të raportimeve periodike, dhe duke qenë se viti 2023 shënoi vitin e realizimit të Censit të Popullsisë dhe Banesave, Këshilli u informua gjithashtu mbi ecurinë e këtij procesi, përfshirë aktivitetet kryesore të realizuara si dhe të organizimit operacional dhe përgatitjeve institucionale.

Gjatë takimeve, anëtarët paraqitën komente dhe sugjerime me karakter teknik dhe strategjik, duke synuar përmirësimin e planifikimit të aktiviteteve statistikore dhe rritjen e përputhshmërisë me standardet e Bashkimit Evropian.

Diskutimet u karakterizuan nga angazhim konstruktiv, vëzhgime teknike dhe këshilla të orientuara drejt përmirësimit të cilësisë, aksesit dhe harmonizimit të statistikave.

Bazuar në raportimet e INSTAT dhe agjencive statistikore, Këshilli vlerëson:

- Performancë të qëndrueshme në përmbushjen e planifikimeve statistikore, duke reflektuar një nivel të lartë të realizimit të publikimeve dhe transmetimeve ndërkombëtare;
- Rritje të kapaciteteve metodologjike dhe digjitale;
- Përparim të dukshëm në harmonizimin me standardet e Eurostat, sidomos në fushën e transmetimit të SDMX dhe adoptimit të burimeve të të dhënave administrative;
- Transparencë më të madhe publike, përfshirë raportim të rregullt, publikim të materialeve dhe komunikim mbi aktivitetet madhore statistikore.

Këto zhvillime përbëjnë një bazë të rëndësishme për forcimin e besueshmërisë së statistikave, si një element kyç për transparencën institucionale, llogaridhënien publike dhe përdorimin e të dhënave zyrtare në proceset e vendimmarrjes, planifikimit strategjik dhe harmonizimit me standardet europiane.

REKOMANDIME

Duke u bazuar në informacionet e paraqitura, analizat krahasimore dhe praktikat europiane, Këshilli paraqet këto rekomandime:

1. Përshtetimi i modernizimit të burimeve administrative të të dhënave, për të rritur cilësinë, aksesin dhe përdorshmërinë.
 2. Investim i qëndrueshëm në burimet njerëzore, përmes formimit profesional të vazhduar dhe skemave të motivimit.
 3. Harmonizim më i thelluar me standardet e ESS dhe rregulloret e BE-së, në veçanti për indikatorët makroekonomikë, bujqësinë, shëndetin dhe mjedisin.
 4. Zgjerim i komunikimit publik dhe edukimit statistikor, për të forcuar besimin publik dhe përdorimin e statistikave.
 5. Përfshirjen në Planet Vjetore të Statistikave të treguesve që INSTAT transmeton në kuadër të platformës SDDS së FMN-së, me qëllim rritjen e transparencës dhe harmonizimit të procesit të raportimit ndërkombëtar.
-